

...dhe
u nisen
vullnetarët



891.883 - 1
DH. 29

18

BIBLIOTEKA E RINISË

... DHE U NISËN
VULLNETARËT

- VJERSHA DHE POEMA -


40252

LIBRARY
GJERGJ KOCANI

12 140

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

VILLASOVA MUSTA



PËRCJELLJA

Buzëgaz, ju na dhatë me vete
shamitë-gjak, ish prindër vullnetarë,
dhe këto hajmali si përshëndetje
ja hapëm ne fushës në fshatin kufitar.

Ne e duam këtë ngjyrë kaq të kuqe:
ngjyrë gjaku e zjarresh partizane,
yje lapidaresh ne mbajmë mbi supe,
ndaj nisemi si yj n'akcionet vullnetare.

Sa i duam ne këngët në udhë!
Po shkojmë me shamt'e kuqe ndër gusha...
Ohej, nënoket tonë ç'na puthin,
nënoke, na lini të na puthin dhe fushat!

Dhe arat e arta, të ngjashme me ne,
me këngë të gjelbra na dalin përpara.
Mbi sy qerpikët si halë i ngre,
me një mendim të gjelbër për arat.

AUTOGRAFI

olaj bari kundë zo zit szencaus
matafifur rihabet dei plejt-vilindra
njohuritëm që la illojitet olli urib
mëpax nitarai fuqësi që mëquri et

zgjedh që pax kryeq qëndri, rastë e pikë
çoncertuar deri tjetër e ulëtura kryeq
zgjedh që pax kryeq qëndri, rastë e pikë
çoncertuar deri tjetër e ulëtura kryeq

BLERIM UGARI...

Njerzit puntorë un' i dua aq tepër,
sa vargjet pér ta më vërshojnë në bllok;
sikur s'më mjaftojnë as penë, as letër,
që vargje pér ta të shkruaj pérherë, shokë.

Me ta un' punova në aksione, në arë,
ku vargjet e mi u freskuan nga djersa,
ku mora blerimin e pastër n'ugar,
që më shpértheu diku, nëpër vjersha.

DY BREZA VULLNETARËSH

Tok me fshatarët u lidhëm në valle:
duart me kallo shtrënguar mes nesh;
brohorasin të qeshur këta male,
një nënë malesh mes nesh buzëqesh.

Sa herë ka qënë në krye të valles:
në hekurudhë dikur qe e para,
syt' ç'i shkrepin ish vullnetares,
ç'i vezullojnë thnjat e bardha...

Dhe shpërthejmë nën tinguj gërnete;
un' dhe ajo dy breza vullnetarësh,
nën shkëlqim kazme dhe bajonete,
pranë një fshati jugor kufitarësh.

DASHURI AKSIONI

U dashuruam pas tokës kaq shumë,
ku lamë këng' e valvitje flamuri,
e prej saj me vete ne prumë
kallo bronxi e ngjyrën prej gruri.

Dhe ësht' e fortë dashuria që mplekset
kur djersin ugari dhe gruri.
Ne dhe gruri shkëmbyem reflekset
në bul a djerse, nën hije flamuri.

NE FESTËN E BATALIONEVE PARTIZANE

IMPERIALE TIRANA

Vallet e këngët duken kaq të bukura,
si ngjyrat e kostumeve krahinore,
kta njerëz puntorë, me fytyra të purpurta,
medaljen e diellit mbajnë n'kraharore.

...Nga malet e shumta kur zbritën dikur
Ne përgjithnjë me vete na prunë
lirinë e shtrenjtë, të mbjellë në flamur,
të shtrenjtën liri, betonuar me punë..

Pranë tyre flamuri i betuar me grusht,
mbahet i sigurt me kazmë dhe pushkë.

NË KANTIER

Po vij me ju, shokë, në kantier,
un', vajza, llaçin në skela të çoj;
dhe do jem kaq e qeshur përherë,
sa gazin në vinça çdo turn ta ngarkoj.

Mijra tinguj dhe mijra rima
do më lindin në skelë, kur të ngjitem,
do të derdhen ato në turbina,
dhe në mijra llamba do ndizen.

...Dhe do thur në kantier përsëri
vargje. Në sfond të ri t'pesvjeçarit,
nën këta tinguj, nëna Shqipëri
sot lulë, kurora u vë lapidarëve.

KOÇI PETRITI



BISEDIM ME MALET

Ju patë të ndeshej Pompei me Qezarë,
tundët kaq djepe t'ilireve-nëna,
shkuan te ky udhëkryq kryqëtarë,
shkeli mbi ju gjysmëhiëna...

Ju mbajtët të gjallë, në gjëmim e jehona,
zërin e Gjergj Kastriotit mbi shpinë,
lindët dhe burra në kohët e vona,
rritet Selam Salarinë.

Mblodhët nën krisma paticakash të reja
çeta rrëth këngëve dhe zjarreve labe,
vajzat i nisët si djem nér beteja,
muzgjeve thatë çorape...

Netve barinjtë mbi ju, krep më krep,
ngjan sikur ngjiten rrufe për të kapur,
krrabën në dor' e gazetën në xhep,
flasin për Letrën e hapur.

Sot ju po shihni të tjerë banorë,
feksin prej kazmave varg këto vise;
mpleksur nér marshe të rrept' e gazmorë,
rend gjenerata e re optimiste...

Male që zgjohi nga mina e borie,
mbjellë me çadra nën mjekrat e blerta,
kaq lumturi studenteske, kaq diej,
kur kini mbajtur mbi vete?...

O KOHË E AKSIONEVE TË MËDHA

O kohë e aksioneve të mëdha,
O ditë të hekurta, të ndriturat ditë,
Ju dolët në skenë nga sinteza e viteve
Siç dalin nga sinteza e popujve gjenitë

DESHIRA E KËSAJ TOKE

Mbi kodra, thellë perëndimit,
dremiste ndonjë re kokulur në horizont,
si kal' i lodhur prej luftimit,
që s'ndahet nga trupi i të zot.

Lirishtet e mbetura djerrë,
të majmura nér shekuj nga gjethet dhe pleh^u,
nga malli të rritnin të lashta,
ushqyen në gji arra dheu¹⁾...

U desh të vinin këto kazma,
këta fshatarë, ushtarë dhe studentë,
që të mos mbetej djerrë tok' e majme,
të mos shkarkoheshin kot retë.

Dhe ngjan sikur me vullnetarët
ndjen gaz edhe kjo re që shi ka pér të dhënë;
nga lumturia, avuj tymos toka
që nesër do të bëhet nënë. . .

1) Një lloj barishte që lidh kokrra nën-tokë, në vendet
djerrë.

ÇASTE NGA JETA E VULLNETAREVE

Rreh anëdeti,
skuq perëndimi,
gloshen shkëmbinjtë e thërmuar nën kreshta,
rrjedhin ujvarat si «Norma» e Belinit,
flenë studentët në rreshta...

Cëndra po shohin tani vullnetarët,
vajzat me duart plot kallo dhe plasa?
Ndofta shpërthimin e minës së parë,
ndofta ullinj mbi taraca.

Vreshtha të ardhëshme,
dallgë ullishtash
zbresin me ëndrat mbi shtratin përdhes,
mpleksur si mijra kordele dhe gishta
rreth kaçurrela studentësh...
Jashtë dezhurni me pushkë bën roje,
pushka të rënd' ja bën hapin, të rrëptë,

pushka mbi sup të studentit.
Netve kështu edhe gjyshërit tanë
ruanin bajlozët e detit.

Rreh anëdeti,
nxin perëndimi,
çlodhen shkëmbinjt' e thërmuar nën kreshta,
rrjedhia ujvarat si «Norma» e Belinit,
flenë studentët në rreshta...

MUSA VYSHKA



NGA FLETORJA E VULLNETARIT

1. DHJETË DUAR

Ne ishim tre. Dhe donim
një trung të madh të shëmbnim,
e shtyjmë me sa mundim
pa çka se duart dhëmbin.

Po trungu është i fortë,
po trungu është i lashtë,
thérresim dhe një tjetër,
kështu u bëmë katër.

Mbi ne vapa krekozej
e djersa bënte sumballa,
e shtynim ne të nxehur
me vetulla të ulura.

Po ja, u desh një tjetër
dhe erdhi një i pestë.
Me vrull një goxha trung
ja mbathi tatëpjetë

U ulëm ne të qeshur
dhe ujë pimë pak,
pa zum' të bisedojmë
edhe të qeshim bashkë.

2. LIRIKE

Ku je ti? Ku t'i than djersët era,
në ç'parcelë mbi lodhjen sulmon?
Unë s'di pse më fort këtë herë
vargu im të të ndjekë kérkon.

Të shikoj nëpërëndra me kazmë:
sikur rreh mbi një gur pa pushim,
djersa jote shpërndahet mbi vargje,
lodhja jote më jep drithë dhe gjëzim.

Ç'tinguj nxjerr ajo kazmë! Mes lodhjes
ti sheh qartë në ditët që vinë;
kush kuption sa kushton lumturia,
di ta çmojë më fort dashurinë.

Sa më pranë kësaj toke t'i rrimë,
aqë më shumë do ta duam atë,
aqë mall do të kemi për shokun
sa asgjë s'do na ndajë përgjithnjë.

Ku je ti? Pyll i Bizës, i rreptë,
diçka thotë me zërin e trashë;
n'ato pyje dikur unë këndova,
për blerimin e lirë diç thashë.

Veç nuk di pse atje këtë herë
vargu im të të ndjekë kërkon.
Ku je ti? Ku t'i than djersët era?
Në c'parcelë mbi lodhjen sulmon?

3. UDHA E RE

Ne hapëm goxha udhë
sipër gurëve,
mbi to skuq vargu i flamurëve.

Kjo udhë e re,
si vajzë e hutuar,
qëndron mes nesh e heshtur, e gëzuar.

Dhe donim ne pa tjetër
të shikojmë
të parët udhëtarë të kalojnë.

Pa gjetëm në korie
e në shkollë
fëmijë fshatarë,
faqekuqë si mollë.

Në rresht i vumë
dhe përpara tyre
vendosëm si shirit një pe me ngjyrë.

Kaloi vargu i gjatë,
u këput shiriti;
t'i shihnit sytë si na ndritnin!

Dhe iku vargu i «inaugurimit»,
humbi plot gaz,
si zog mes gjelbërimit.

Ne rrnim
edhe udhën e uronim,
gjithnjë nën tinguj këngësh ta shikonim.

Të mbajë gjithnjë
nxënës të gëzuar,
dhe burra trima
me kazëm e pushkë në duar.

BETIM MUÇO



PËRSHËNDETJE SHOKËVE

Të përshëndes, armatë e rinisë,
falang' e re e zemrave të zjarrrta!
Vërshuam ne nën thirrjen e Partisë
t'i bëjmë agimet tonë më të arta.

Ky vendi yn'i lashtë dhe i bukur.
një t'ardhme më të bukur po ndërton,
ndaj sot kudo boria jon' e sulmit
Krenare, madhështore po ushton.

Ne dim' të dashurojmë dhe të qeshim,
të ëndërrojmë majat më të larta,
Dim si burrat vështirësit' t'i ndeshim,
të shpartallojm' pengesa dhe bllokada.

Si det' i thellë jan' mundësitë tonë,
për lodhjen brezi ynë s'do të dijë;
jan' leva më e sigurt këta muskuj
në duart e së ardhmes që do vijë.

Të përshëndes, armatë e rinisë,
falangë e çeliktë zemërjarr!
Un' ja arrita kulmin lumturisë,
në vij' të sulmit ja, sot jam ushtar.

K R E N A R I

Shiko këtej, në kodrat përbri detit
lëshon zjarr kazma që mban dora jonë,
në kallot që forcuan këto duar,
ndër mend do sjellim ne aksionin tonë.

Kjo tok' me lapidare dekoruar
na thirri sot për punë të mëdha
ndaj në taracat, brigjeve të kaltër,
të gjelbërojn' ullinjtë sa më la.

Dhe zemra rreh me zjarr ndër kraharore,
me forcë mbi shkëmbinj kazma qëllon.
Po, shokë,jeta është madhështore
kur ideali ne na frymëzon.

Të detit dallgë këngë do këndoijnë
këtu, nën gjelbërimin e ullinjve,
do t'i këndoijnë këngë djersës sonë
dhe miqësisë së madhe të të rinjve.

SHOKUT TË LARGËT

O shoku im i largët vietnamez,
të përhëndet nga Shqipëria mike
një bir i denj' i popullit me besë,
që s'i përfill distancat gjeografike!

Këtu ne, në aksionin e rinasë,
treqind përqind e kryem normën sot,
si solidar të luftës së lirisë,
si solidar të luftës suaj, shok.

Si mos të derdhim rrëkë ne djersën,
kur ju po derdhni gjakun rrëke?
Çdo çast mendimi ynë si shigjetë
në vendin tuaj fluturon, atje.

Pas jush qëndron rini' e gjithë botës,
qëndron mur i çelikt' i popujve.
Ja shkrepni agresorit mu në zemër
ju pushkën e hakmarrjes dhe pér ne!

Dhe përmbi tokën tuaj heroike
do shkrep diell' i fitores një mëngjes;
at'here bashk' do shkojmë në aksione,
o shoku im i largët vietnamez!

NË MUZGJET FLOKEARTË

Në muzgjet flokëartë
të netëve verore,
me gaz të gjithve zemra
na rreh ndër krahare.

Të gjérat hapësira
përmbi atdheun tim,
ndjejn' këngën aksioniste
nga Kruma gjer në Vrinë.

Si kapilarë gjaku
për ty jemi, atdhe,
ndaj tingëllon krenare
kjo kënga jon' e re.

Agimet do t'i ndezim
me zjarr të ndritur zemre,
të pastrat ndjenjat tonë
jan' nota t'kësaj kënge.

Në punë do ta njobim
ne nderin dhe lavdinë,
në punë do kalitim
të artën miqësi.

KËNGA OPTIMISTE

Këtu ne rrимë kur mbrëmja zë bie,
dhe këngën e valës dëgjojmë,
në detin e gjerë lundron një anije,
të mbarë lundrim i urojmö.

Ca tinguj kitare kudo shpërndan era
dhe ne i pasojmë të gjithë;
do vimë këtu edhe net të tjera,
n'aksionet e ardhshme t'rinishë.

S'ka gjë nëse zemrat pushton mallëngjimi
për ditët që shkuam këtu,
përpara ësht'jeta, pérpara gëzimi,
ne zemrat na flasin kështu.

Taracat e gjera në brigjet e detit,
ku djersën s'kursyem në gara,
i bëm' aerodrome të ëndrave tonë
për jetën që kemi pérpara.

Ne jemi armata e re që këndoymë
at' këng' që na lan' trashëgim,
në detrat e jetës mes dallgësh do shkojmë,
krenarë gjithmonë me guxim.

KTHIM KRENAR

Fluturoni, këngë, si pëllumba,
ne po vimë nga aksioni, shokë!
Përshëndesim mijra njerëz, turma; —
jo kapelet, zemrat mbajm' në dorë.

Sjellim dhjetra kallo nëpër duai,
romantikën tonë aksioniste,
zemrat e çelikta farkëtuar
në të madhen farkë komuniste.

Po ju sjellim buzëqeshjet tona
lule të agimeve që vinë.
Ja, atje ku djersa derdhet lumë
ne e shohim të jetës lavdinë.

Ju, të dashur shokë vullnetarë,
dhe ju, që përshëndesni ndër ballkone!
Tok gjithmonë do t'i sulmojmë vitet,
s'thinjen kurre flokët ndër aksione.

Fluturoni, këngë, si pëllumba,
ne po vimë nga aksioni, shokë.
Si vullkane të shpërthejnë gjokset,
ta shpérndajn' gëzimin përmbi tokë.

BEATRIÇE BALLIÇI



GEZIM PAS PUNËS

Të shoh tek kthehe duke qeshur,
t' shkëlqejnë sytë nga gëzimi.
Moj vullnetare llërpërveshur,
për ty më lindi frymëzimi!

Të shoh tek kthehe e gëzuar,
plot entuziazëm, krenari,
për normën që ke tejkaluar,
të qeshin sytë, t'këndon shpirt'i ri!

I DUA TË ËMLAT AGIME

I dua të ëmblat agime,
kur dielli derdh rreze mbi det,
kur qielli ndron ngjyrat e rralla
dhe shelgu ngre kryet i qetë.

Dhe muzgun e hirtë e dua,
perëndimin e bukur ndër valë
dhe mbrëmjet e arta të fshatit,
kur hëna nxjerr kryet në mal.

Në punë i njoha agimet,
kur hidhja lopatat me dhe.
Sa t'bukur më ngajn' perëndimet
mes vrullit që ke, o atdhe!

NE, VULLNETARËT

I lamë ne të gjatat bulevarde
dhe trotuaret mbushur lule plot,
i lamë dhe soditjet nga dritaret,
kur era me petale lulesh lot.

I lamë bankat, të dashurat mikesha,
që bashk' me ne qeshën apo qanë,
i lamë pas ne klasat, koridoret
dhe kopështin e shkollës aq të gjanë.

U nisëm drejt fushave të atdheut
mes pyjesh hijerënd', gjith' qetësi,
me ballin lart, plot forca, të paepur
përpara çdo penges' e vështirsi.

Në vend të librit morëm ne lopatë,
në vend të notës, kallot nëpër duar.
Se ç'u kalitën muskujt delikatë
pran shkëmbit t'thespir duke punuar!

PAS PUNËS

Pushojnë tani shokët, vullnetarët,
dikush ditarin hapi përsëri,
një tjetër sheh flamujt e punës, kallot,
dhe ndjen në shpirt gjëzim e krenari.

Pushojnë të gjuar vullnetarët
nën qiellin blu, mbështetur më një anë,
ndërsa të tjerët thurin èndra, këngë,
dikush lot gishtat lehtë në kitarë.

Dëfrejnë tani shokët, vullnetarët,
disa të tjer' lexojnë me dëshirë,
dikush me dashuri një letër shkruan:
«Të dashur prindër! Jemi të gjith' mirë!»

SHEFKI KARADAKU



CIKËL PËR TË 20.000

1. UDHEMBARË!

100,
1000

20.000
marshojmë
si një trup gjigant,
kudo.

Sot
«Udhembarë»
ti, Parti
sypishë,

në emër

të atdheut

na uron.

Kush nuk u sul

atje ku dora

jote

si semafor

kohor

tregon:

marshim!

Përpara

shko,

rini

e Shqipërisë! . . .

«Puntor!»

fjalë plot shpuzë

e historisë,

e mbarsur

nga lavdia

e pamatë!

100

1000,

20.000

si gjak i pastër

derdhen në çdo cak

nën forcën

e çuditëshme

të Partisë.

Marshojmë

nën një diell

luftarak.

2. MËNGJESI I PARË I PUNËS

Këtu s'ka salla dhe leksione
dhe shtrat studentë plot përtesë;
këtu ti je ushtar
që zgrohe në orën 4.05.

Hop,
dhe në këmbë që të gjithë;
s'ka të fërkohesh
si maçok!
Pa lindur dielli i dërrë
atdheu na thërret, o shok!

Ç'leksion i bukur
ky mbi tokë,
kur kazma ulet mbi një breg.
Metal,
djersë
dhe forcë
enigma zgjidhet shpejt-e shpejt.

S'do mend, ne lodhemi të gjithë,
kur dheu i thekur
avullon,
por pikërisht
kjo sakrificë
dremitjen-shtrigë
na ë zbon.

3. MBRËMJA

Mbrëmje e kaltër,
mbrëmje boj' gri,
shokë për katër
hedhim ne valle,
valle tani.

Qënka se ç'qënka,
gajdja e shkretë!
Hopa me zdrënka,
shokë studentë,
hidhi të lehtë!

Vajzat gazmore,
vajzat-perri,
vallen djelmore
shohin gazmore
vajzat-perri.

Njëraavec plepat
ëmbël shikon,
hënënd dhe degët.
Shkruan mbi letra
vargje ajo.

Qënka se ç'qënka
gajdja e shkretë!
hopa me zdrënka,
shokë studentë,
hidhi të lehtë.

4. NATA E FUNDIT

Harmonikë, harmonikë,
ti ushton nëpër çdo cak,
qesh e bucura sydlirtë
me djaloshin luftarak.

Nat' e fundit dalngadalë
po afrohet në mbarim,
me rromuze edhe fjalë
ecin vajzat pa pushim.

Nat' e fundit studenteske
po vrapon mbi çdo la mullar
hén' e fushave po qeshet
sipér plepit, llampadar.


amér' ea c'zis
'tisztile a zibiq
sziszibx em zibiq
öltöök a zibiq
éjtol' zt' zibiq

ТІМУР И АТАК

Öltöök öltöök
zibiq zibiq
sziszibx em zibiq
öltöök zibiq a zibiq
sziszibx em zibiq

Öletszibx zibiq a zibiq
sziszibx em zibiq
öltöök zibiq a zibiq
sziszibx em zibiq

SKËNDER TEMALI



DËSHMORI NË AKSION

Dikur,
te kjo luginë
luftë e përgjakshme, shok'u ba
Dikur, te kjo luginë
partizani në luftë kishte ra.

Tani në luginë
ngrihet lapidari i dëshmorit.

Tani në luginë
shpalosim flamujt e aksionit.

Çdo ditë në apel,
nën qiellin blu,
sekretari emnin ja thërret
dhe n'emën të tij brigada
«Këtu» gjegjet dhe buçet

Një normë plotsojmë për shokun dëshmor,
një letër e shkruajm' për nanën e tij
dhe t'gjithë e besojmë
se me ne jeton,
si unë dhe si ti.

VULLNETARJA E LICEUT

Gishtrinjt' e tu si qumështi
shpesh viteve shëtitën mbi tastierë.
Gishtrinjt' e tu aty mbollën
plot lule të kuqe me erë.
Por në aksion duert qumështore
i shndrove ti në duer puntore.

Përsëri, çdo natë,
gishtrinjt' e tu na zhysin n'andërrime
dhe duert me kallo,
që kallijt, korrin
e mbjellin lule,
andrat na i bajnë të vërteta.

ZANAT E AKSIONIT

Atje n'malet e thepisun,
me ylbere të qëndisun,
ku agimet rrugën nisin,
zanat lugjet kanë braktisun.

Se në malet mjekërbardhë
zana tjera paskan ardhë.
Nuk janë zanat në legjenda,
Por janë vasha të vërteta.

Që nga bank' e shkollës erdhën
ktu, ku djepin e ka dielli,
mbi shkambbij djersën derdhin,
që ma i kaltër të jetë qielli.

Në krah njena ka qysqi
dhe një tjetër kazmë ka,
hapin rrugë për në malsi,
me maqinë n'qytet me ra...

...Atje n'malet e thepisun,
me ylbere tē qëndisun,
ku agimet rrugën nisin,
zanat lugjet kanē braktisun.

ODHISE GRILLO

A tje p'maiset e tjerësi
me lypere te dëndinu
ku shumet lirësu i liri
nuqet jetet kung përshtatjen

NE DHE NËNAT TONA

Nëno,
po nisem në aksion,
m'urop:
— Rrugë të mbarë!
Shamitë tundin nënët në ballkon
dhe përshëndesin
mijra vullnetarë.
Arrita në Rradhimë,
ti ndofta s'di ku bje...
Këtu,
në re e mbështet kokën Vetëtimal¹⁾
dhe deti
poshtë fle.
Un'punës ja kam nisur,
me mijëra të tjerë...

1) Malet e Vetëtimave (Akrokerauni).

Një kopësht do ta bëjmë,
të stolisur,
sykaltërën rivierë.
I bëmë kodrat shkallë,
të ngjitet Shqipëria,
me pushkë,
kazmë
edhe yll të kuq në ballë
drejt majave ku fle lavdia.
Nëno,
po kthehem nga aksioni,
po vij si fitimtarët...
Shamitë tundin nënënat
te ballkonit dhe përhëndesin vullnetarët!

KODRAT E RADHIMËS

Në verë gjelbëronit
dhe çdo vit,
në vapën që dhe gurin zhurit,
me kore zogjsh
bregdetit i këndonit.
Në dimër,
gjelbërimi
si me magji braktiste kodrat,
me shi e breshër
koha niste lodrat
dhe ju mbulonte krejt trishtimi.
Tek ju po vijmë me sopata
dhe dwersë do të derdhim,
do të presim
mare,
gjeshtra
o lofata,
si me maqinë, zero do t'ju qethim.
Pastaj taraca do të çelim,
ullinj do mbjellim
çhe limonë,

një vello gjelbëroshe do t'ju hedhim
që ta gëzoni
dimër,
verë,
përgjithmonë!

SHI NË MESNATE

Karaburuni ngrysi ballët,
në horizont
vrapojnë retë e marra...
Mesnatë.
Tetëqind studentë radhë,
po shohin sonte
ëndrat më të bardha.
Po shplodhin gjymtyrët.
Fle Radhima...
Si gjarpérinj
rrëshqasin nëpër natë, flakë;
na gjuan që nga lart
me vetëtima
Çika plakë.
Të tetëqindët
ngrihen nëpër gjurmë.
bregdeti nga tallazet
sikur çmëndet...
Nga sipër
shiu rrjedh mbi ne si lumë.

nga era
kapanoni shëmbet.

Na gjuan Çika ne
me vetëtima,
litarë shiu na rrabin
porsi drurë.
Po s'do t'ja dijë hiç Radhima,
këndon
dhe tund me krenari flamurë!

TRI RACA

Studentëve të huaj që punuan krah për
krah me ne në Radhimë.

Moj kodr' e Radhimës,
taraca

të rrika e bukur,
si brez...

Këtu

punojnë të rinj nga tri raca:
të bardhë
të verdhë
të zes.

Nga Kina ka ardhur Li Çini,
me librin e Maos në xhep...

Me gjuhën marksiste
Pekini

Radhimës

kinezçe i flet.

Me ne punon edhe Nami,
i shtrenjti

shok edhe mik...
me armë në dorë

lufton Vietnamit,
atdheu i tij heroik!

Ka ardhur së largu këtu
një djalë
që qesh dhe këndon...

Mendu,
i dashur Mendu,
mos vallë sot Kongon kujton?

Radhimë!
Sot djersë po derdhin
në kodrat e tua
të rintjtë,
që nesër
plot lule të çelin,
të paqes simbole:
ullinjtë!
Moj kodr' e Radhimës,
taraca
të rrrika e bukur,
si brez...
Këtu
punojnë të rintj nga tri raca:
të bardhë,
të verdhë,
të zes!

ndök ugnat ū qulba a
... ūnjb ūn
... nobet ūb deng ū

ubatā mudech i
fincus gōmāl iea illav pors
COPA KENGESH

— Balladē —

I.

Kodrat kësaj ane,
seç më duken porsi labe,
veshur me tumane¹).

Janë zënë dor'përdore...
Edhe ku ta dish,
ndofta heqin ndonjë valle,
valle lebërish.

II.

Po ç'ju panë sytë vallë,
kodra gjelbërore?
Araniti këndej brodhi
me të tijt' taborre.

1) Tumanet janë të zeza ose shumëngjyrëshe.

Lamtumirë, turkoshakët
i than' kësaj bote,
se provuan mbi kurriz¹
shpatën radhimjote.

III.

Po ç'ju panë sytë vallë,
kodra rreth e qark?
Një pusi, zënë pas gardhit,
të ngritur një hark.

Me gjak lave çdo sinor,
moj Radhim' e shkretë,
për një copë tokë shterpë,
seç të mbetën djemtë.

IV.

Radhimjotët gunëgrisur,
në vitin njëzet,
seç i hodhën italianët
brënda mu në det.

Flisni dushqe e lofata,
plot me flet' e rrëmba,
kush u hodh në këto kodra,
mbi telat me gjëmba?

V.

Nëpër kodrat me marishte
na dolën fshatarët,
moj Radhimë, duarbosh
ktheve taksidarët!

Deshën bukë, po ti s'kishe
një pëllëmbë tokë,
seç u dhe në vend të bukës,
nga një plumb në kokë!

VI.

Moj Radhimë, këtë radhë
vure yll të kuq,
nxore pushkët e gjerdanët,
fshehur në sënduq.

Nga një pushkë e një sëpatë
kishte në çdo prak,
këto kodrat e Radhimës
u lanë me gjak.

VII.

Nga Radhima zbritën Vlorë
mijra partizanë
dhe lirinë, si dhuratë,
Vlorës plak ja dhanë.

Vlora labe me qylaf
e me tallagane¹⁾
dil e priti nga çdo anë
çetat partizane!

VIII

C'm'i shërove gjithë plagët
që të lanë plumbat,
përmbi kokë, moj Radhimë,
të sillen pullumbat.

I bashkove gjithë ç'pate:
mallin edhe ëndrat,
ndaj të gjithëve tani
u këndojnë zemrat.

IX

O ju kodrat e Radhimës,
mbushur mare e dushk,
katërmijë vullnetarë
ju kan' ardhur krushq!

Shkallë-shkallë seç ju bënë
të rejat, të rinjtë,

1) Tallaganet janë një lloj sharku apo bruci.

m'i gëzofsh përgjithmonë
vreshtat dhe ullinjtë!

X.

Dhe e luftës, dhe e punës...
Hiq, Radhimë, valle!
Do të ngjash buzës detit
si një shtojzavalle.

Ç'të stolisën anembanë
sivjet vullnetarët,
ti me mall do t'i kujtosh
universitarët.

XI.

Seç u bënë krejt taraca
kodrat kësaj ane,
dhe më duken porsi labe,
veshur me çitjanë¹⁾

Janë zënë dor'përdore
e me gaz trifish,
për Partinë po këndojnë
këngë lebërish!

1) Çitjanet = tumane.

ZHULJANA G. JORGANXHI

KUR LINDA UNË

Kur linda unë, vajz' e dytë,
gjyshja ja qau hallin nënës sime,
psherëtiu duke fshirë sytë:
«Eh, tha, vajza ka aq halle e shqetësime!»

Por unë s'e njoha atë jetë,
një tjetër rrugë mori fati im.
S'u enda rrugëve pa shpresë,
s'kërkova strehë,
dhe pak gjëzim.

Kur linda unë, nëna më këndonte
këngë me fjalë krejt të reja.
Nuk ish, pra, nina-nana e zakonshme,
në të më bukur shpërthente
gazi dhe hareja.

Sa herë eca e çkujdesur
rrugëve të qytetit tim!...

Me një fustan basme veshur,
prodhim i parë i Kombinatit Tekstil.

E shihja tim atë nganjëherë
të lodhur nga pun' e ditës,
s'e kish nevojë Shqipëria atëhere
për bukë,
për veshje,
për dritë!

Dritë!

Që mbi ty atdhe mos rëndonte
padija si natë e zezë,
që vajza te burri mos shkonte
si plaçkë në treg e blerë.

Mbi gjoksin muskuloz të atdheut
mbështeta dhe unë dorën time,
ndjeva si buçiste dheu
nga këngët,
marshet
dhe gëzimet.

E kësaj toke jam filiz i ri
dhe rrënjet i kam ngulur mirë.
Më rriti dora jote, o Parti,
mes ajrit të pastër,
në tokën e lirë.

Parti,
o pulsi i jetës sime!
Mbi krahët e tua këngën do ta ngre,
ti gaz u jep të mijave mendime,
me ty oxhaqet do t'i çojmë
në re!

Ti gjak më dhe nga gjaku yt
dhe nënë e dytë për mua je,
qysh kur më lidhe atë shami,
si gjak nga gjaku yt, PARTI!

Bashkë me shokët dua të punoj,
që nesër mos më quajnë «delikate».
Sot është koha që duhet të krijosh
dhe vjersha
dhe këngë
dhe pallate!...

Linda për socializëm unë,
ndaj e tij e gjitha do të jem,
gëzimn' e jetës do ta gjej në punë
e jo atje,
ku er'e mykut

frymën ta merr
e të zbeh..

S'u mbështolla unë në mëndafsh,
në dremitje s'do bije asnjëherë.
Atdhe,

ty fjalën sot ta jap:
gadi do jem unë kurdoherë!
Se ti rinin' e do të shëndetshme,
të fortë,
të bukur si vetë Shqipëria.
Mbi supet e saj i sigurt të mbështetesh
me duart e saj ajo të bëjë çudira!

SAMI BOGDANI

VULLNETARËT E TU

Mbas rrugës së madhe me plepa
 mbeti shtëpia, qyteti.
 Skodat vrapojnë,
 rrëshqasin,
 buçasin si deti.

Dhe ngrihet kënga
 dhe hapet nën qiellin e madh blu.
 Shqipëri, sërish hapiu gjinë
 vullnetarëve të tu!

Po vijmë
 ne që dje bankat i lamë,
 që aromën e tokës,
 që dashurinë tënde
 ta ndjejmë më pranë.

Po vijmë.

Nga djersa jonë të njomet kjo tokë.
Ne fjalën e dhënë,
si dikur etërit tanë,
pa tjetër do ta mbajmë, shokë!

Me aksione ne jetën do masim,
flamuri çan si shpatë.
Ti prina, Shqiponjë,
gjithmonë
në rrugën e ndritur,
të gjatë.

PËR TY, E HEKURTA RINI!

Ende mbi mal
s'ka çelur dielli,
po lugjet tejpërtej zhurmojnë,
përposh ngre valë Adriatiku,
shkëmbinjtë
dallgët i thërmojnë.

Kush janë ata
që rendin bashkë,
si një agim i madh mbi det?
Janë vullnetarët aq gazmorë,
që ngjiten kodrave
përpjetë.

Dhe mbajnë mbi supe
kazma, kosa,
kjo tokë e shtrenjtë do blerim.
Në vend të gjëmbit dhe të ferrës,
shkëlqeni, pemë,
pambarim!

Do shkojnë vitet,
det i kaltër
do thurë këngë përsëri,
do tundin degët portokallet
për ty,
e hekurta rini!

Si një agim
që rend përpara
ti do të mbetesh përgjithmonë,
gjurmët e tua madhështore
mes shekujsh
malet do t'i çojnë.

SULEJMAN MATO



FERFERIJNE FLAMUJT E AKSIONEVE

(Poemë)

1.

Përditë agimet lindin më të kuq,
përditë më e ndritur bëhet jeta ime.

Kjo poemë u shkrua
me rrezet e para të agimeve,
faqe kodrave,
në rreshtat e taracave,
kur po lindte dielli i kuq, i kuq,
që prapa maleve.

Këto ishin mëngjeset tonë
më të ndritura,
kur në sfond të fushave,
në kodra dhe mële,
ne, me kazmat dhe me djersën tonë,
shkruam për atdheun
poemën më të madhe.

*

Poema e mbjellur në thellësi të kodrave
me vargje hardhish,
e me rima ullinjsh,
në rreshtat e taracave zuri rrënje të thella
do gjallërojë përjetësisht
pra:
Tani t'i kujtoj të gjitha në radhë...
Gjithë ditët plot dritë
vullnetarët plot këngë zgresin prej mbresave,
në vargje hyjnë ndër vargje,
 valviten flamujt e aksioneve.
Dhe marshojnë prap kështu mbi atdhe
 vullnetarë... .

Në vazhdën e ndritur të komunistëve,
dielli i kuq

shpalos prap flamurët
e njëzetmijë aksionistëve.

Kështu i nise fluturimet, rini!
Ditë të kaltra, aksion i parë,
në përfytyrimet e mia valvituni përsëri,
kujtimet e dashura të verës së bardhë!
Kamionët, shytat vrapojnë veri.

Mirupafshim qytete,
stacione,

nëna,

adresat tonë të reja do jenë
malet,

pyjet,
fushat,
kodrat.

Në fusha!

Në fusha! — thërrasin boriet.

Zemrat cicërojnë si zogj midis grynjash.

Tokë e dashur, shpalosu nën rrötë,
natyrë shqiptare plot reflekse dhe ngjyra!

Tokë e dashur, strehona në gjë,
mbulona me pyjet e tua të blerta!

E nise shtegtimin e parë, rini,
si zogjtë shtegëtarë kur ndrojnë foletë,

Rend ti, moj erë,

sulu, veri,

sihariqin e madh shpërndaj nëpër kodra,
thirrjes së partisë

që sot do t'i falim
shpatullat tona.

Në pyjet e dëndura
do çajmë ne rrugë,
në majë malesh do ngremë flamurët,
në fushat e gjëra në agim do të korrim,
këngët tona
dhe ëndrat tona.

2.

Po ç'ndjemë natën e parë
mes fushës,
kur frëgëllonte hëna
si një llambë fshatare?
Malet ninulla në gjumë na kënduan
me një lahutë të thjeshtë malësore.

Në ëndra ne ndjenim shqetësimin e kodrave,
fëshfërimën e grynjave
si dallgë plot lumturi,
në çast zemrat tona po akordoheshin
në një këmbanë madhështore.

*

Ranë borijet e zgjimit të ditëve,
u derdhëm ne
pranë flamujve
nëpër kompani,
atë mëngjes korriku kambana e atdheut
nisi të lëkundej me një timbër të ri.

N'atë kambanë madhështore
zemrat e njëzetmijë vullnetarëve.

Rend ti, moj erë
sulu, veri;
këngë aksioniste,
vrapo nëpër kodra!
Letrës së hapur
sot, Parti,
ne do t'i falim shpatullat tonë.

Këto kodra djerrina
nëpër ferra, nënë driza
do të rrisin grurë kalliaz
tokë e lashtë,
gëzohu e gëzohu
si gjyshja kur ndjen ndihmën e nipërve të saj!

Në frontet e para të sulmeve ne
qëndruam si në pozicionet luftarake,
rëndonte dielli i korrikut mbi ne,
frynte erë...
Valviteshin flokët e ngrirë nga djersa.

Djersën e parë për ty, o tokë,
e mbollëm në rreshta taracash të gjatë,
së bashku me dhuratat e tjera në shekuj
pranoje dhe djersën tonë dhuratë...

3.

Nga puna kthehen brigadat aksioniste.
Valviten në erë flamujt e kuq.
Në gojë marshi i Letrës së hapët,
vrapon kjo këngë nga brigada në brigadë.
Në duar shtrëngojmë dyrekë flamujsh.
Mbi ato shtiza të drunjta, të thjeshta lëndësh
pylli, valvitet epopeja.

e mbushur plot lavdi.

E rëndë, shok', por madhështore
Është e popullit histori.

Ka atje copa gjaku të qëndisura në flakë,
ka atje betime për një ideal të ri;
në sfond të kuq,

të 28 mijët

valviten në përjetësi.

Dhe kështu rëndoijnë mbi ato drurë pishe
plagë të rënda,

ëndra,

këngë...

Po ne të gjitha i ngremë mbi supe
në mëngjese,
në mesditë,
gjer në mbrëmje vonë.

Mbrëmjeve,

kur muzgjet rëndoijnë përmbi kodra,
mbi kampet tonë, rrëth zjarreve partizane,
fërfërijnë flakrat,

valviten nëpër net,

si flamuj të lavdishëm të historisë shqiptare.

4.

Në netët e kthjellta,
pranë zjarreve partizane,
kënduam ne e hodhëm valle
e kështu u përzien tingujt e një lahute malësore
me tingujt e një kitare.

Nëpër telat e lahutës
e nëpër telat e një kitare,
si nga një gurrë e lashtë, e pashterur,
rridhte e tërë jeta shqiptare.

5.

Malet me legjenda në gjumë na vinin,
me këngë kreshnike e me lahutë
malet histori bajlozash na rrëfenin...

E na faniteshin ne, ashtu tek flnim,
bajlozë të hershëm tek zbrisnin nga malet,
linin topuzët dhe kuajt te porta,
futeshin nëpër kapanone
e në ëndrat tona.

*

Ëndrat përgjysmë na i prisnin agimet,
hypnin mbi kuajt bajlozët, iknin prapë,
gjëmonte çanga në degën e varur...
Këto ishin alarmet e jetës së re,
alarmet madhështore
të Letrës së hapur.

Dhe kështu, duke kapërcyer gjumin, ëndrat,
shalonim mëngjeset

me kazmat, lopatat
e rendnim në fusha
e ngjiteshim në male.
Mijra flamuj të kuq të vullnetarëve
i bënин fresk natyrës shqipëtare.

6.

Kodrat e xhveshura,
malet e larta
ruanin në thellësi
miliona dashuri,
miliona përkëdhelje,
ruanin në gii (si perla të harruara)
ninulla vreshtash,
dashuri ullinjsh.

Duhej një forcë e paparë në histori
t'u rritëte shpresën kodravë,
t'u shtonte fuqinë maleve.
Fara e parë qe mbjellur në thellësi,
do lindte pér pavdekësi:
Partia Komuniste Shqiptare.

7.

Parti!

Ne jemi gjelbërimi yt i pashtershëm
në sfond të ditëve-agim i ri
jemi gjaku yt që zbriti në fusha,

jemi drita jote që u ngjit në malsi.

Gjithë këngët tonë për ty janë, Parti,
këngë të rinjsh në fusha e male.

Kjo këngë që po lindej për aksionet,
...dhurata ime për ditëlindjen tënde për ty,

8.

Këto kodra djerrina
nën ferra, nën driza
do të rrisin grurin kalliaz.
Tokë e lashtë,
gëzohu... gëzohu,
si gjyshja kur ndjen ndihmën e nipërve të saj!

Këto flokë të pakrehura
në këto kodra e male të thinjura
do t'i djegim si me korent elektrik,
në vend të tyre mbi to të mbijë
një flok i dendur bojëjeshil.

Këto breza taracash, në marshimin e viteve,
krahas krenarisë shekullore të maleve,
të përjetshme do të mbeten në gjelbërimin e tyre.
më të përjetshme se piramida e Keopsit
dhe gjithë piramidat egjiptiane.

9.

Në përfytyrimet e mia valvituni përsëri
agime të kuq

prej flamuj aksionesh,
borizanët në agime të tillë tani
lajmërojnë orët e dhimbëshme të ndarjes.

— Mirupafshim, kodrina!
— Njatjetani, male!
Po ikim, po ikim!
Na presin auditorët.

Mirupafshim, mirupafshim
ditë të lumtura!
thërrasin boriet...
uturojnë maqinat.
Në gjokse na ndritin «S» e punës,
si lulëkuqe mes grynjash.

Ka sjellë inxhenjeri një botë me vete,
agronomi i ri një ëndër mbi shpinë,
studentja e re në fushat e gjëra,
ka mbjellur dashurinë.

Të mbledhura si fletët
nëpër lulet e malit,
mblodha dhe unë nga aksionet ca mbresa.
Së shpejti do t'i fus nëpër vargje e strofa
e stivë-stivë nëpër vjersha.
Në sfond të ditëve të tua,

atdhe

po shkojmë ne vargje-vargje,
poemat e para të shkruara nga ne
do të gjelbërojnë horizonteve të ardhshme.



KËNGË PËR KANTIERIN MË TË RI TË BOTËS

(fragment nga poema)

— Prolog —

Qëkurse lindën kantieret ndërtimtare,
në këtë vend, ku këllëf'i shpatës ndryshk zinte
ngaqë shpatës kurrë s'i ra rasti të puthej me të,
të fërkohej me të,
perënditë u zverdhën dhe ranë si gjethet në vjeshtë

dhe u zhdukën.

Dhe u thanë.

Dhe nuk janë.

Në vendin e tyre çelën sythet e rinj të mendimeve
të reja,

dhe sythet shkrepën buqeta rrezesh të zjarra,
si një numur dijesh pa kufi.

Dhe në quell u zhduk terri.

Dhe natyrës iu vu freri.

Dhe shqiptari e pa veten perëndi.

Po

perënditë si gjethë ranë nga degët e qiejve

dhe era i struku në zgavrat e errta

të shekuje që shkuan,

i struku ndër pralla dhe legjenda,

ndër muhabete plakash të moçme.

Dhe natyra u bë e kuqe.

Dhe njerëzit u bënë të kuq.

Kështu ndodh gjithmonë kur lindin kantiere ndërtimtare,

kantiere si tonat.

kantiere të kuq,

kantiere si ky,

ndonse është më i riu i botës.

Agimi i parë,

Si një triumf i një beteje madhështore,

zbriti nga malet

Kudo kantiere,

kudo aureola njerëzish ndërtimtarë.

Vetë Shqipëria — një kantier i madh!
Ndërsa ne — punëtorët e këtij kantieri!

七 宋 水

Edhe Nebiu është punëtor i këtij kantieri,
më tepër se punëtor —
sulmues.

Veç ta vështrosh Nebinë
kur rrezet e diellit i zhyten në djersë:
ai bëhet i artë,
si është dhe puna që bën,
si është dhe zemra që ka,
si është dhe vendi ku rrон...

Perëndimeve
ai shëtit pranë valëve.
S'iu mërzitën nië herë valët e detit,
dhe Nebiu vazhdon shëtitjen e tij,
duke humbur në flakën e perëndimit,
ndërsa dielli tej, si nië medalion i artë,
varet teposhtë për në det.

3.

Ky është kantieri më i ri i botës,
me të ardhmen e tij — një zinxhir të pafund
këngësh të kuqe.
Ky është një nga kantieret shqiptare,
një mësim i Partisë në praktikë.

Dhe ndaj kantieri për Partinë,
për të pestin kongres të saj
vendosi të ngrihet
mbi 100%

Kështu tha kantieri nga altoparlanti,
kur vullnetarët shkemuan gjumin,
kur vullnetarët mblodhën fuqitë,
kur agimi trokiste atje, majë malit,
me yllin e mëngjesit.

Më pas u ngjit përpjetë
për t'i dalë agimit përpëra
me shifrën e shkruar në ballë,
ndërsa poshtë
deti vazhdonte të flinte gjumin eëmbël të mëngjesit.

. , , , ,
* * *

Dita e bardhë, si një nuse të dielën e martesës,
baret mbi valët e detit që ngreh filladi,

e freskët, e gjallë
dhe gjithmonë prodhimitare.

Kazmat buçasin

Edhe toka gjëmon

gjëmon toka nga kazmat që ngulen,

Rënkojnë kazmat nga muskujt e moçëm

të tokës djerrë,

të tokës së zezë,

që zbërthehet

në dritën e bardhë

të ditës së re.

. , , , ,

Ja skuadra e «shqiponjave» në brigadën e Drejtësisë.
ja Nurja sulmuse,
Sofika,
Donika
(e ëmbla në zë!)
të palodhurit studentë që nga Kina e largët,
koreanët,
vietnamezët e Vietnamit heroik,
indonezianët,
perujanët,
pedagogët tanë
si pastrojnë vendin nga copat e muskujve të dheut.
Ja edhe Nebiu...
luftojnë dhe s'jepen.
Kantieri vazhdon të punojë.

Në mbrëmje kantieri nuk dolli të shëtisë
buzë detit.
Ai u ul në një tavolinë të mensës,
ai mendohet,
ai kristalizon të derdhurën djersë
në shifra.
Si do dalë?
Dhe kantieri shkruan
nën dritën e kuqërrëmtë të perëndimit,
kurse deti hesht, deti pret.

.. .Kur ja: Urra-a-a!
Deti lëvizi.
Dielli nxori kryet që prapa resë,
flladi ngriti letrat.

Këtë të shtunë,
zotimi
s'mbahet dot
nga gëzimi:
mbi 100%
Fitore!

* * *

Pastaj në kantier pati mbrëmje vallzimi.
U shpallën edhe sulmusa.
U dha edhe koncert.
Këndoi edhe Donika
me të emblin zë të saj...
Veç të shihje taracat sa bukur ishin veshur,
sa bukur ua shkelnin syrin
kavalierve të tyre —
sulmusve!

Ditë e shënuar...
Çdo ditë tek ne është e shënuar,
sepse çdo ditë sjell një agim të ri,
sepse çdo ditë çel një horizont të ri,
sepse çdo ditë shton në rrugën tonë të re
disa metra të reja.

Rruga zgjatet.
Zgjatet rruga,
por jo si fill
i një lëmshi të mbledhur që më parë.
Ajo është e re.
Njerëzit që ngjiten, e hapin vetë
me duart e tyre,

të prirë nga piketa,
që shekujt dot s'i grijnë,
dhe në çdo kthesë tabela:
«Diell»!

«Greminë»!

Dhe njerëzit ngjiten.
Netët s'ua nxijnë dot mendimin,
mendimin-diell.

që bën mrekullira.
Rruja zgjatet.

Njerëzit ngjiten
dhe kënga e tyre ndërtimtare
shpërndahet anembanë
tokave ku duhet djersë.

Kënga!
Kënga e kuqe!
Kënga e gjallë!
Kënga e shpirtit komunist!

Kënga e këtij kantieri!
Ndërsa qindra lapidarë
si raketa
ngrihen e lartësohen,
gjersa humbasin
në buzëqeshjen e qiellit
ngjyrë blu...

* * *

Nata vazhdonte të flinte akoma
me kokën mbështetur mbi gjunjë,
kur zbriti nga lindja agimi
me kutinë e votimit në dorë.

Deti...
E ç'është deti përpara kauzës sonë?
Sa një gogël,
sa një ruazë
në tokën tonë.
Tek ne e nesërmja i ka themellet
tek e sotmja,
dhe të sotmen ne e kemi të pavdekëshme,
sepse kutinë e votimit
ne nuk e ngjitim në katin e sipërm,
ku s'arrijnë dot të gjithë,
ndaj edhe të nesërmen ne e kemi të pavdekëshme
si malet tonë...

Këto mendonte kantieri atë të dielë,
ndërsa vështronë nën dritën e trëndafiltë
të agimit,
nën dritën e së ardhmes,
kutinë e votimit,
atje, n'atë dhomë të thjeshtë,
Në më modesten dhomë në botë.

Kantieri voton.

Edhe ai ngjitet në rrugën e re.

Ai është më i gëzuari në këtë dhe:

shikon ai në kutinë e votimit

jetën e vërtetë,

qiejt e së ardhmes pa një re.

Rendnin ditët si valët e detit
njëra pas tjetrës,

e dyta gjithmonë më e madhe se e para
dhe kantieri bëhej më ~~ezmer~~
më muskuloz.

Tani

ai s'ka kallo e muskuj vetém ndër duar,
por edhe ndër supe,
edhe në bark,
edhe në gjoks,
sepse mbasditeve kantieri stërvitet,
sepse mbasditeve kantieri futet më thellë
rrathëve të vegjël
tutje shënjestrës.

Kantieri mbasditeve bëhet ushtar,

merr frymë si ushtar,
ecën si ushtar,
shtrihet në tokë tamam si ushtar
dhe, i shtrirë, ai ushqehet me krisma pushkësh,
që nesër të paftuarin ta ushqej, me plumbë.

Sa bukur i shkoka
kazma dhe pushka!

• • • • : : :
Sa agime,
sa perëndime,
sa djersë,
sa sulmues,
sa kalitje!

Dhe kështu erdhi dita,
kur kantieri ngriti «shtratin» në heshtje
dhe hipi ndër kamiona,
me gjoksin e rëndë nga «S»-të.

Edhe një herë dielli u gozhdua atje, pér mbi det:
përcjell kantierin më të ri të botës,
përciell kantierin më të kuq të botës,
që u fali kodrave djerra
buzëqeshjen e pérjetëshme,
ndërsa nesër portokajt e artë do t'u flasin shekuje
pér kantierin më të ri të botës.
(Ahere kantieri do të jetë burrë,
me flamuj heroizmash ndër duar,
dhe me diej të artë gjoksi plot...)

* * *

Ja, sheshi para flamurit mbeti prapa, imbetën prapa mensa,
kapanonët e thjeshtë...
Vetëm deti s'na ndahet
ai na përcjell.

Edhe taracat s'na ndahan
ato na buzëqeshin të mbytura në lot.
Po ikim.

S'do dëgjojmë zérat:

«Erdhi autoboti!»

s'do lexojmë më shënimin:

«Përdore ujin me vend!»

s'do t'i dëgjojmë më thirrjet e orës tre,
kur agimi jepte sinjalin atje, majë malit,
me yllin e mëngjesit:

«Çohuni, çohuni, shokë!

As urdhër dite,

as gjëmime deti,

as meloditë e mbrëmjeve s'do t'i dëgjojmë...

Dhe të gjitha këto vetëm pér një vit.

Vetëm për një vit, o kodrat e dashura,
që gjithmonë na doni!
Na doni,
Sepse ju zgjuam nga gjumi i moçëm,
ju dhamë gëzimin,
ju falëm buzëqeshjen.

Maqinat ecin
si një varg i pambaruar diejsh të kuq.
Çdo gjë mbetet mbrapa

e fotografuar në kujtesë.
Mirupafshim, taraca!

Kantieri ecën
dhe deti humbet që prapa ullinjve,
ndërsa dërgon buzëqeshjet,
buzëqeshjet e kaltëra të brigjeve të arta...
— Mirupafshim, det!

O copë qelli e rënë në tokë!... —

I kthen kantieri pëershëndetjen,
duke tundur dorën nga majat e ullinjve.

Jonufër 1966.

KOÇI PETRITI

M E S D R I T H È R A V E T

P o e m è

1
Prap' mora valixhen me vete,
Po nisem për udhë tani.

Jam gati, kurdo, me një frymë
Çdo rrugë n'atdhe ta përpjek.

Pas shpine askush s'do të tallet:
«Si ikën kështu, mor i gjorë,
«Ku dielli, i penguar nga malet,
«Gjith' ditën s'të sheh as dy orë?»

Por ja, që për prehje s'jam prerë
Që ditët kaq bosh t'i rrufis
(Të ndenjurat ujra mbajn' erë
Mes hiesh, kur gjeth nuk lëviz.)

Pas shokëve të mbetem nuk dua
Dhe kurrë me kaq xhelozë
S'm'i ndezi askush ndjenjat mua,
Sa zëri i atdheut tani....

2

Ky qënka një fshat pak i largët,
Me arat mes maleve t'egër
Dhe toka aq shumë s'mban vlagë,
Ndaj mbillet më tepër me thekër.

Un' erdha këtu, midis jush,
Jo t'ulem si pleqtë në shesh,
Por kosha me pleh do të mbush
Dhe krahët mbi bërryl t'i përvesh.

Të lodhem dhe unë bri bujkut,
Ku brazdave rend çafkëlori,
Ku zbardh edhe feks, në të zhdukur
Të diellit, mes arave plori.

Të rrok si fshatar në të korra
Një drapër me dorëz prej briri,
Të kruhem kur ëmbël, nën sqetull,
Më shpon një mustaqe kalliri.

Dhe si mund tē mbetem i huaj,
Kur era tē lashtat lëviz?
Kur nxijnë mullaret si buaj
Dhe hëna çdo gjë kallais?

«Këtu arançatë nuk pinë,
Ndonjéri as emrin s'ja di,
Por ti do tē gjesh në çdo stinë
Hoshaf, e pekmez, e raki.

Pas vattrash, në netët e ftohta
Dëgjon historira, vëlla;
Ngjan' kënd i veçuar nga bota,
Po rron me ndodhit' e mëdha.

Ne ishim dikur tē pagdhendur,
Por librat, ama, na i kish ènda.
I ndanim fëmijët nga shkolla,
Se dhitë na mbeteshin brënda...

...Armiku i klasës, sa ngryste
Lëvrinte dinak e nervoz
Që rendin e ri ta përbyste,
Punonte gjithnjë nën rrugoz.

Pat' sherr dhe kur tokat për ndarje
Litar' i këshillit i mati,
Sa ligjin e ri një nga shokët
Me gjakun e vet e spërkat.

Por ti duhet mirë ta dish:
Pa re s'mund të shkrepë rrufeja,
As lufta nuk bëhet pa trima,
As paqja pa nuse të veja.

Dhe ja, s'na braktisi guximi
Ta ngremë çdo fshat si qytetin...
Dhe dihet që shpesh, nga fërkimi,
Merr zjarr drur' i ri me të vjetrin.

I riu mund t'u thotë sot etërvë:
«Pa shihni! S'kullosim sot pata.
«Po t'ishim dhe ne n'ato vite,
S'do kishim një varg dekorata?...»

Kështu m'u rrëfye një mbrëmje
I pari që njoha në fshat,
Në fshatin, ku njerzit s'të lënkan
Të mbetesh aspak fillikat.

4

Në jonxhët, pranë çezmave dhe vijave,
Ka rënë për së dyti kosa,

Rend shtërgu pas të bijve dhe stë bijave
Dhe bën të heshtin pellgjeve bretkosat.

Nga horizontet radiot fushës derdhin
Muzik' e lajme, gjersa vjen mesnata.
Në kopshte ndonjë breshkë samarverdhë
Nxjerr kokën dëgjon ritme dhe ballada.

Këtu pëllitj'e kaut është mpleksur
Me gulçet e gërvimat e traktorit,
Që dhëmbët ngul stërnishtave të djegura,
Teksa mbarojnë korrësit së korruri.

Mes misrave, pas brazdave, në radhë,
Sa zbardhellen i bien vajzat shatës,
Pa ngjajnë, që nga larg, shamt' e bardha
Si delet në kangelet e De Radës...

...Në vatrën e kulturës ndizet vallja,
Çunakët gdhijnë kuajt nér kullota
Dhe mua më zgjerohet frymëmarrja,
Kur pi të tilla net, që s'i njeh bota...

E shoi traktorin fshatari,
Fshatarkat shatat i lanë.
Qetë përtypen në mes të nj'ugari,
Sikur thashetheme po hanë.

Kusitë me qumësht u hoqën nga zjarret,
Thur vajza gërshetat e trasha.

Një film do të shohin në lëmë fshatarët,
Mbi luftra në kohë të lashta...

Ti, fisi im,

Lindur e ngrysur me dhi në kullotë.
Thirre kur pe përtej malesh katunde:
«Ua, dhe këtej paska botë!»

Miu, po të binte në magjet e tua,
Kokën e thyente pas fundit
Zverdhnin si lulet e kungullit foshnjat,
Mburrej i pari i katundit.

Mburrej për dorza kamxhiku të veshura n'ar.
Hypur mbi mëzin e tredhur prej race.
Brënda mendimit të tij mesjetar
Nxinte një quell injorance.

Deheshin burrat e lodhur,
Mbeteshin gratë shtatzëna.
Ti mbaje shtrirë pëllëmbën e ndotur,
Fall të të shtinte fatħena.

...Ndonse u krruse nga skamja mbi brazda,
Mbete i pastër, shpirtfoshnjë.

Ti, nëpër festa pagane dhe dasma,
Ngjyrat e shpirtit çpalosnje.
Ti, fisi im
Plot reumatizëm,
Brejtur prej fyterjeve, hallevë,
Vallë si munde kaq shum' optimizëm
Të mbjellësh mes këngve dhe valleve?

Hej, fisi im,
Ulur në muzgje, mbi shtretër prej balte,
Sofrën e kishe të varfër,
Por ti jetëshkrimin të pasur e pate.

E kini vënë re fshatarin tonë,
Që prapa kokën e ka rrafsh?
Ndofta pse s'i vu nëna, që në djep,
Jastëk me pupla dhe mëndafsh.

E dini ju pse ka vështrim të thellë?
Pse dorën e ka plumb të rëndë?
Sentokën, nëpër mjergull e ka mbjellë,
Me gjysm' o pingë, pushkë dhe iparmendë.

Dhe pse gjithnjë kasolle e kullë ai
I bënte me dritare aq të ngushta?
Mos donte që t'i kish dhe përfrëngji,
Të mbante nën shinjestër pyjet e fusha?

Dhe ja, mbas kaq rrebesheve që ikën,
Shqiptar i zymt', i rrept' e koskëstrallët
Rrudh ballin ta kuptoj' agroteknikën,
Siç i kupton dhe kuajt nga dhëmballët.

7

I kanë plasur buzët makinistit,
U është xhvoshkur qafa qeve,
Vlaga ka dalë nga plasat e plisit,
Toka ndjen mall' e rrufeve.

Bujkeshave u janë pjekur llërët,
U është mpleksur byku nëpër flokë,
Mendim i tyre, èndër nëpër èndër,
Qënka shpérndarë në çdo kokërr...

Qënka shpérndarë në çdo kokërr gruri,
Qënka shpérndarë në çdo fije.
I shoh ato edhe në punë burri,
Edhe t'i japid gji ndonjë fëmije.

Nuk dinë të vënë hollë krem fytyre,
Por dinë ato si bëhet buka,
Si emrat e fëmijëve të tyre,
U zgjedhin lopve emrat më të bukur.

Dhe èndërojnë qengja, pleh dhe shira
Të rritet misri det parcelavet.

Me gishtérinjt' e trashur dhe tē nxirë
Ato qëndisin bukur, mbrëmjevet.

...Makinëshirësja, nofullahekurt,
Përtyp e gëlltit mijra duaj.

Unë tani mes fshatarve kam hyrë,
Vrahun po kthej... e ngas kuaj.

I kanë plasur buzët makinstit,
Taliket ngrenë tym në rrugë;
Mbrëmjeve, lëmi shpërndan erë plisi,
Erë benzine dhe bukë...

8

Grigjat kullotat e ngrëna
I lanë dhe zbritën më poshtë.
Mbi lëm' e mbi kroje shket hëna,
E verdhë si tas me kulloshtër.

Kush mund tē mbetet pas mureve?
Kush mund tē mbyllët në dhomë?
Ajri thith mushtin e drurëve,
Era tund biskun e njomë.

...Shtrihesh mes fushe, në lëmë,
Shtrihesh mes lëmit, në kashtë.
Delet bariu mbledh nën hënë,
Leshin e qethur bën bashkë.

Flokëspërkatura nga vesa,
Gazi të hyn gjer në palcë.
Ndodh që këmishën e kripur nga djersa
Vjen ta lëpin një dem race.

Digjet mbi kryet e mia
Ylli si kok e një llulle
Sonte, përveçse këtu poezia
M'e madhe, në ç'vënd mund të vlej

9

Dehur nga era e plisit, e plehut,
Shoh prapa togjesh me grurë, me elb.
Sofrën e madhe t'atdheut.

Shoh këta burra të bronxët, të shkathët,
Krrusur mbi cfurqe, krrusur mbi thasë,
Krrusur mbi vrahun e madh të përbashkët.

Shoh dhe mendoj:
Brir' i alarmit të ndihej tani,
Brir' i rrezikut të huaj,
Cfurqet do kthenin fshatarët e mi,
Hasmin ta ngrinin si duaj.

Ne më modernet armë do ngjeshnim,
Ne do t'i linim përgjysmë të korrat.
Ky mund të ishte alarmi m'i tmershëm,
Alarm' i panjohur nga kohrat.

Frap, do të brofnim nën tingujt e marshit,
Kurrë nën këngë të trishta,
Edhe me kosa e makina silazhi
Hasmin ta grinim, siç grijmë misrishta.

Larg do të mbartnim mbi shpinat e nxira
Mllefin e burrave,
Vrerin e grunjave,
Mbetur pas nesh të pashira.

10

Më mbërtheu tani në gji natyra,
Ku mendim i bukës bukë pjell.
Lodhj' e punës, mbirë mbi fytyra,
Me të lashta zemrën ma mbështjell.

Dhe s'u thinj kjo tokë nga kaq lindje,
Por bleron ajo nga këngët tonë;
Gjithënë, e freskët dhe me bindje,
Rrit kallinj të rinj, shpërndan aroma

Se u dashka gjith kjo pjellori,
Duhet bar' i butë si gëzof,
Duhet që të piqet ky kalli,
Pa dikush të bëhet filozof.

Plugu zbardh e brazda hap nē hamull,
Unē rend mes bujqérve tē mbjell.
Tok' e bryllët, toka qē nxjerr avull,
Me tē lashta zemrën ma mbështjell.

Gusht 1966

Q1

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Faqe

VLLASOVA MUSTA: Përcjellja	3
Blerim ugari	5
Dy breza vullnetarësh	6
Dashuri aksioni	7
Në festën e batalioneve partizane	8
Në kantier	9
 KOÇI PETRITI: Bisedim me malet	10
O kohë e aksioneve të mëdha	12
Dëshira e kësaj toke	13
Çaste ngajeta e vullnetarëve	14
 MUSA VYSHKA: Nga fletorja e vullnetarit:	16
1) Dhjetë duar	16
2) Lirikë	17
3) Udha e re	18
 BETIM MUÇO: Përshëndetje shokëve	20
Krenari	22
Shokut të largët	23
Në muzgjet flokëartë	24

	Faqe
Kënga optimiste	25
Kthim krenar	26
 BEATRIÇE BALLIÇI: Gëzim pas punës	27
I dua të ëmblat agime	28
Ne, vullnetarët	29
Pas punës	30
 SHEFKI KARADAKU: Cikël për të 20.000	31
1) Udhembarë	31
2) Mëngjesi i parë i punës	33
3) Mbrëmja	34
4) Nata e fundit	35
 SKËNDER TEMALI: Dëshmori në aksion	37
Vullnetarja e liceut	39
Zanat e aksionit	40
 ODHISE GRILLO: Ne dhe nënët tonë	42
Kodrat e Radhimës	44
Shi në mesnatë	46
Tri raca	48
Copa këngësh	50
 ZHULJANA G. JORGANXHI: Kur linda unë	55
 SAMİ BOGDANI: Vullnetarët e tu	59
 XHEVAHIR SPAHIU: Për ty, e hekurta rini!	61
SULEJMAN MATO: Fërfërijnë flamujt e aksioneve (poemë)	63
 ILIA NIKOLLA: Këngë për kantierin më të ri të botës (fragmente nga poemë)	74
 KOÇI PETRITI: Mes drithëravet (poemë)	85

5760

1970

Tirazhi 5000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tirane, 1967